



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 02.03.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:03 dhe mbaroi në orën 11:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 2 mars 2020 fillon me prezantimin e pikës së rendit të ditës nga Kryetarja së Këshillit, zonja Naureda Llagami.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues nr. 1512 prot., datë 02.03.2020 lidhur me përmbajtjen e projektvendimit: “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër që është në listën e gatishmërisë për këtë periudhë, konkretisht: znj. Mirela Iliopulli.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Pëllumb Vehbi, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor